



VENDIM

Nr. 114 Datë 16.11.2011

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “DITEKO” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET NE LUMIN
“ZALLI I OKSHTUNIT”: “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”,
“PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”,
“OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DITEKO” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DITEKO” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuar nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “DITEKO” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et ne lumin “Zalli i Okshtunit ” :“BOROVE” me fuqi 1,921 MW, “ZABZUN” me fuqi 0,301 MW, “SEBISHI” me fuqi 2,835 MW, “PRODAN 1” me fuqi 0,38 MW, “PRODAN 2” me fuqi 0801 MW, “OKSHTUN EKOLOGJIK” me fuqi 0,45 MW, “TERNOVE” me fuqi 0,921 MW, “OKSHTUN” me fuqi 10 MW, “LUBALESH 1” me fuqi 4,6 MW, “LUBALESH 2” me fuqi 5,1 MW dhe “GJORICE” me fuqi 4,18 MW, për një periudhë 30 vjeçare.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI